



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 256, Datë 23.08.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEALB ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “GURI I BARDHË 1” ME FUQI TË INSTALUAR 5360 KW DHE “GURI I BARDHË 2” ME FUQI TË INSTALUAR 3940 KW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 9300 KW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/1 prot., datë 21.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” me fuqi të instaluar 5360 kW dhe “Guri i Bardhë 2” me fuqi të instaluar 3940 kW, me fuqi totale të instaluar 9300 kW, në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fashati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., datë 17.08.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati

Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e licencimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar në zbatim të përcaktimeve të Rregullores dokumentacionin për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”, si dhe për pikën 2, gërmat “a”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Të depozitojë vërtetimin e gjëndjes gjyqësore nga Drejtoria e Burgjeve për administratorin dhe shoqërinë “Glealb Energy” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Të vërtetojë që nuk ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore.
- **gërma “b”:** Të sjellë letër interesi të rinovuar në afate, që reflekton interesin e Bankës për financimin e këtij investimi duke saktësuar normën e financimit, ose të dokumentojë/informojë në ERE nëse shoqëria ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me bankën apo kontratë financiare, origjinale/të njësuar me origjinalin.
- **gërma “c”:** Të depozitojë planin e biznesit në format origjinal/ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të plotësuar.

- **gërma “b”**: Të depozitojë në ERE, Kontratën e Konkensionit, Amendimin e Kontratës dhe Kontrata Shtesë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- **gërma “c”**: Të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, në rrjedhën e përrrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër me kapacitet të instaluar 9300 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI